



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:065813

Datë: 01.04.2022

Numri i dokumentit: 02870376

P.nr.1006/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. B. nga Gjilani për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Arton Haziri nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1319/2018 të datës 05.11.2018, me datë 30.03.2022 mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A. B. nga babai F. dhe nëna M., e lindur M., i lindur me datë 09.08.1971 në Gjilan ku dhe jeton rruga “.....”, rruga III, numër 24, i pa martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, invalid i luftës, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 09.09.2018, rreth orës 19:40 minuta në Gjilan, rruga “Haqif Tetova” numër 9, në oborrin e shtëpisë familjare të dëmtuarit, me paramendim dhe duke përdorë forcën ndaj personit tjetër të dëmtuarit E. B. ashtu që pas një zënke verbale për shkak të një borxhi së pari të dëmtuarin e ka kapur me duar për qafe dhe e ka tërhequr që ta nxjerr nga oborri, e kur i dëmtuari ka filluar ta shtyjë me duar dhe kur kanë dalur në oborr edhe anëtarët e tjerë të familjes, i pandehuri është larguar dhe ka ikur.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP-ës të pandehurin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumën prej 250 € (dyqindpesëdhjetë euro) të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari E. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumë prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm me datë 05.11.2018 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr. 1319/2018 kundër të akzuarit A. B. për shkak të veprave penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 të KPRK-ës¹ dhe veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Me datë 29.09.2021 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit dhe i pandehuri A. B.. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-ës me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit ndërsa nuk e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 të KPRK-ës me ç'rast gjykata e ka njoftuar të njejtin se në afat prej 30 ditësh mund të paraqet kundërshtimin ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

2.Vlerësimi i pranimet të fajësisë

¹ Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 36 të KPP-ës për të pandehurin A. B. sa i përket veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-ës e ka veçuar procedurën penale.

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezent. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza gjithashtu gjykata me rastin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri A. B., ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës dhe mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se i pandehuri ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e tija sepse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se i njëjti ka paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale si dhe faktin se i njëjti këtë vepër e ka kryer me dashje dhe atë direkte, gjykata pati parasysh sjelljen e mëparshme të pandehurit si dhe pranimin e fajit nga ana e të pandehurit ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga ana e tij për kryerjen e veprës penale e cila i vihej në barrë, faktin se për të njëjtin ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për vepra të tilla penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se i njëjti këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke qenë i

vetëdijshëm dhe duke e ditur se me veprimet e tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj i njëjti e ka dëshiruar dhe ka ndërmarrë veprimet siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënim brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj tij mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Vendimi lidhur me ricilësimin juridik të veprës penale dhe zbatimin e ligjit më të favorshëm

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe bazuar në nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-ës në të cilin thuhet se “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”, po ashtu faktin se zbatimi i veprimit retroaktiv të ligjit është obligim i gjykatës dhe se me rastin e ndryshimit të ligjit duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin erdhi në përfundim në këtë çështje penale duhet zbatuar dispozitat e kodit penal numër 06/L-074 i cili është tani në fuqi meqenëse dispozitat e këtij kodi sa i përket dënimit të paraparë për këtë vepër penale janë më të favorshme për të pandehurin.

5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Gjykata duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarin E. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurit ta detyrojë që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e dëmit të shkaktuar, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1006/2018 me datë 30.03.2022

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.